



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 8158 prot.

Tiranë, më 31/12 /2020

URDHËR

Nr. 456 datë 31/12 /2020

PËR
MIRATIMIN E FORMATIT, PËRMBAJTJES, MËNYRËS SË KRIJIMIT DHE
ADMINISTRIMIT TË REGJISTRAVE TË SHËRBIMIT TË PROVËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar dhe të nenit 24, pika 5, të ligjit nr. 78/2020, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës", me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës,

URDHËROJ:

1. Regjistrat e Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës, në zbatim të nenit 24, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 78/2020, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës", krijohen në formatin manual me shkrim nga strukturat përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, sipas formatit dhe përmbajtjes së përcaktuar në anekset bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij.
2. Regjistrat e Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës administrohen nga Degët Territoriale të Shërbimit të Provës, sipas formatit të përcaktuar në anekset bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij.
3. Miratimin e "Regjistrit të personave nën mbikëqyrje" sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij. Regjistri i personave nën mbikëqyrje ka në përmbajtje të dhënat, si vijojnë:
 - a. Dega Territoriale e Shërbimit të Provës;
 - b. Identiteti (emri, atësia, amësia, mbiemri)
 - c. Datëlindja;
 - ç. Vendlindja;

- d. Gjendja civile;
- dh. Shtetësia, kombësia;
- e. Profesioni;
- ë. Numri personal i identifikimit;
- f. Adresa e vendbanimit;
- g. Numër telefoni;
- gj. Vepra penale;
- h. Vendimi gjyqësor;
- i. Dënimi i dhënë;
- j. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim IEVP) ku ka vuajtur dënimin;
- k. Lloji i sigurisë së IEVP-së;
- l. Hyrja dhe dalja nga IEVP;
- ll. Vendimi i gjykatës për dënimin alternativ;
- m. Lloji i dënimit alternativ;
- n. Periudha e mbikëqyrjes;
- nj. Data e fillimit të mbikëqyrjes;
- o. Data e përfundimit të mbikëqyrjes;
- p. Të tjera; dhe
- q. Specialisti i Shërbimit të Provës.

4. Miratimin e “Regjistrit të kërkesë-ankesave” sipas Aneksit nr. 2 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij. Regjistri i kërkesë - ankesave ka në përmbajtje të tij të dhënat si vijojnë:

a. Dokumentet hyrëse:

- i. Numri;
- ii. Data e mbërritjes;
- iii. Shkalla e sekretit;
- iv. Institucioni;
- v. Numër Prot;
- vi. Data; dhe
- vii. Shkurtimi i lëndës.

b. Dokumentet dalëse:

- i. Shkurtimi i lëndës;
- ii. Subjekti të cilit i dërgohet;
- iii. Data e dërgimit;
- iv. Sektori që ndjek zbatimin;
- v. Numri i dosjes së arkivimit (e përhershme/e përkohshme);

5. Miratimin e “Regjistrit të shkeljeve dhe mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimin gjyqësor” sipas Aneksit nr. 3 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

Regjistri i shkeljeve dhe mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimin gjyqësor ka në përmbajtje të tij të dhënat si vijojnë:

- a. Numri;
 - b. Lloji i shkeljes/ detyrimi i mospërbushur;
 - c. Shkaku i kryerjes së shkeljes;
 - ç. Data e kryerjes së shkeljes;
 - d. Momenti i konstatimit të shkeljes;
 - dh. Personi nën mbikëqyrje/ i mituri në konflikt me ligjin;
 - e. Specialisti i Shërbimit të Provës; dhe
 - ë. Masat e marra ndaj personit nën mbikëqyrje/ të miturit në konflikt me ligjin.
6. Miratimin e “Regjistrit të organizatave jofitimprurëse, të institucioneve shtetërore ose subjekteve private”, që ofrojnë këshillim dhe asistencë për të dënuarit me alternative të dënimit me burgim, sipas Aneksit nr. 4 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij. Regjistri i organizatave jofitimprurëse, i institucioneve shtetërore ose subjekteve private ka në përmbajtje të tij të dhënat si vijojnë:
- a. Numri rendor;
 - b. Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT) i organizatave jofitimprurëse, të institucioneve shtetërore ose subjekteve private;
 - c. Emri i organizatave jofitimprurëse, të institucioneve shtetërore ose subjekteve private;
 - ç. Përfaqësuesi i organizatave jofitimprurëse, të institucioneve shtetërore ose subjekteve private;
 - d. Të dhënat mbi asistencën e ofruar; dhe
 - dh. Shënime.
7. Miratimin e “Regjistrit për raportet e vlerësimit të kërkuara nga gjykata ose prokuroria” sipas Aneksit nr. 5 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij. Regjistri për raportet e vlerësimit të kërkuara nga gjykata ose prokuroria ka në përmbajtje të tij të dhënat si vijojnë:
- a. Numri rendor;
 - b. Organi që ka paraqitur kërkesën për raport;
 - c. Objekti i kërkesës;
 - ç. Personi nën hetim/ i pandehuri/ i dënuari/ personi nën mbikëqyrje/ i mituri në konflikt me ligjin;
 - d. Specialisti i Shërbimit të Provës; dhe
 - dh. Shënime.

8. Regjistrat plotësohen dhe në rast ndryshimesh përditësohen nga punonjësi ose punonjësit e Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.
9. Regjistrat numërtohen në çdo faqe dhe përmbajnë përkatësisht 100 fletë (200 faqe) me letër "A3". Çdo fletë vulolet me vulën e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës. Numërtimi fillon me numrin 1 (një). Numrat në regjistër nuk duhet të marrin fraksion, ato janë unikë.
10. Në faqen e fundit të regjistrit vendoset shënimi: "Ky regjistër përbëhet nga 100 fletë të numërtuara e të vulosura, të cilat u sekretuan sot më datë (shënohet dita, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit përgjegjës i cili ngarkohet për mbajtjen e shënimeve)". Ky shënim vulolet me vulën e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.
11. Shënimet në regjistër bëhen me shkrim dore, me bojë blu dhe në një rresht të vetëm. Në krye të çdo faqe të regjistrit bëhet emërtimi i regjistrit sipas llojit të tij.
12. Përveç "Regjistrit të personave nën mbikëqyrje" i cili ka format të posaçëm, në regjistrat e tjerë çdo faqe është e ndarë në 20 rreshta, ku çdo rresht është i ndarë në varësi të të dhënave që përcaktohen në pikat 4, 5, 6 dhe 7 të këtij urdhri. Nuk lejohet të shkruhet në më shumë se në një rresht dhe të lihen rreshta bosh ndërmjet regjistrimeve.
13. Regjistri i personave nën mbikëqyrje, është i ndarë në 23 rreshta në të cilat shënohen të dhënat e cituara në pikën 3 të këtij urdhri dhe shënime të tjera nga specialisti i Shërbimit të Provës. Nuk lejohet të shkruhet në më shumë se në një rresht dhe të lihen rreshta bosh ndërmjet regjistrimeve.
14. Kur në regjistër nuk mund të regjistrohen më veprime, për shkak se ai është plotësuar, punonjësi i strukturës përgjegjëse bën shënimin e mbylljes së regjistrit, duke shënuar datën, muajin, vitin, numrin e fletëve e faqeve të regjistrit, nënshkrimin e tij/saj dhe vulën e degës territoriale. Regjistri i mbushur vendoset në arkiv dhe mbahet në ruajtje duke respektuar rregullat dhe afatet mbi legjislacionin në fuqi për arkivat.
15. Kur regjistri është plotësuar për arsye të ndryshme dhe nuk mund të përdoret më, kur është e mundur të shkruhet, në rreshtin e parë pas regjistrimit të fundit nga punonjësi i strukturës përgjegjëse vendoset një vijë e kuqe me shkrim dore dhe bëhet shënim për nxjerrjen jashtë përdorimit, duke shpjeguar arsyen, datën (dita, muaji, viti), emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e punonjësit të strukturës përgjegjëse. Ky shënim vulolet me vulën e degës territoriale.

16. Regjistrat, mbyllen në fund të vitit kalendarik. Në mbyllje të regjistrit bëhet shënimi sipas pikës 15 të këtij urdhri.
17. Gabimet në regjistra korrigjohen me një vijë të drejtë me stilolaps të thjeshtë mbi tekstin e regjistruar gabimisht, duke siguruar që teksti të mbetet i lexueshëm. Informacioni i saktë më pas shënohet në po atë fushë pa mbuluar tekstin që përmban gabimin
18. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë për ndjekjen e këtij urdhri dhe Shërbimi i Provës për zbatimin e tij.
19. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË


Etilda Gjona (Saliu)



REGJISTRI I PERSONAVE NËN MBIKËQYRJE

Aneks nr. 1

Dega Territoriale e Shërbimit të Provës _____

Emër, Mbiemër _____

Nr.	TË DHËNA PERSONALE	SHËNIME
1	Atësia	
2	Amësia	
3	Datëlindja	
4	Vendlindja	
5	Gjendja civile	
6	Shtetësia, Kombësia	
7	Profesioni	
8	Numri personal i identifikimit	
9	Adresa	
10	Numër telefoni	
11	Vepra penale	
12	Vendimi Gjyqësor (Nr. Data, Gjykata)	
13	Dënimi i dhënë	
14	IEVP ku ka vuajtur dënimin	
15	Lloji i sigurisë së IEVP-së	
16	Hyrja dhe dalja e IEVP-ia	
17	Vendimi i gjykatës për dënimin alternativ (Nr. Data, Gjykata)	
18	Lloji i dënimit alternativ të dhënë	
19	Periudha e mbikëqyrjes	
20	Data e fillimit të mbikëqyrjes	
21	Data e përfundimit të mbikëqyrjes	
22	Të tjera	
23	Specialisti i Shërbimit të Provës	

